

EDMOND MALAJ

BALECI NË MESJETË

Një ndër qytetet e vjetra mesjetare që ndodhen në afërsi të Shkodrës është qyteti i vogël Baleci, i hasur nëpër dokumente edhe me emrat *Balecium*, *Baleç*, *Balezo* ose *Baleço Ballegio*, *Ballesio*, *Baleçio*¹ dhe që kohën e lulëzimit të tij duhet ta ketë pasur në shek. XIV². Mbi këtë qytet hasim disa të dhëna tek Ippeni, Farlati, Jireçeku, Shuflaj, Schmitt etj. Burimi i parë mesjetar ku haset emri i qytetit është shkrimi i Presbiterit Diocleas rreth viteve 1200, por forma e emrit aty është e prishur, duke e shënuar si “*iupa Barizi*”³, d.m.th. “*Zhupa e Balecit*”, i cili e rendit Balecin në dhjetë zhupat që i përkisnin krahinës së Zetës. Përveç Balecit (*Barizi*) në këtë dhjetëshe gjejmë edhe zhupat e Koplikut



Fig. 1: Maja e Balecit, ku ndodhej dikur qyteti.
Foto: Edmond Malaj 2012

¹ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV. I (1400-1405)*, përgatitur nga Injac Zamputi dhe Luan Malltezi, redaktor përgjegjës Aleks Buda, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1987, dok. nr. 18, 28, 35, 37, 108, 204, 223, 302, 306, 310, 364, 415, 436, 480, 459, 570.

² Oliver Jens Schmitt, *Das venezianische Albanien (1392-1479)*, München: Oldenburg 2001 (Südosteuropäische Arbeiten 110. Für Südost-Institut München Hrsg. v. Edgar Hösch und Karl Nehring.), f. 96.

³ Milan von Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters*. Vorgelegt in der Sitzung am 24 April 1918. Kommissions-Verleger der Akademie der Wissenschaften in Wien. Wien/Leipzig: Hölder-Pichler-Tempsky A.-G. 1924, f. 25.

(*Kupêlnik*) dhe të Oblikës (Obliquus)⁴, tek të cilat haset emri i qytetit. Ajo çfarë shkruhet në veprat e këtyre autorëve është shumë e pakët, në të shumtën e rasteve nuk e arrin as edhe një faqe libri, dhe të gjithë pothuajse përsërisin të njëjtat të dhëna, me përjashtim të ndonjë detaji të vogël.

Me anë të këtij artikulli, të bazuar qoftë në autorët e sipërpërmendur, qoftë në burime dokumentare tentohet, të tejkalohet ajo çfarë është shkruar deri më sot mbi këtë qytet dhe të hidhet sadopak dritë në historinë mjaft të errët dhe enigmatike të këtij vendbanimi mesjetar, për të cilin deri më sot, pothuajse nuk gjejmë as edhe një të dhënë në të gjithë historiografinë shqiptare. Problemi kryesor për hulumtimet rreth Balcit është varfëria e madhe në dokumentet që kanë të bëjnë me historinë e këtij qyteti. Artikulli është i ndarë në dy pjesë që trajtojnë dy aspekte të ndryshme të tij: botën laike (të dhëna rreth qytetit, popullsisë dhe ekonomisë së tij) që është pjesa e parë, dhe botën fetare, që është pjesa e dytë e artikullit ku trajtohet historia e dioqezës, ipeshkvisë dhe e klerit të Balcit mesjetar.

Të dhëna rreth qytetit

Emri i Balcit, duket se ka origjinë ilire dhe na kujton fjalën *ballë*.⁵ Balcit përmendet që në kohën e “Dyndjes së Popujve”, më saktë gjatë një kalimi të avarëve dhe sllavëve nëpër territorin tonë, kryesisht në shek. VI, të cilët e shkatërrojnë qytetin.⁶ Gjatë këtyre sulmeve të bëra nëpër provincën e Prevalit u shkatërrua edhe qyteti i Dioklesë, banorët e të cilit kaluan pastaj në Tivar, kurse qytete të tjera si Shkodra, Budua, Ulqini,

⁴ Constantin Jireček, *Handelstrassen und Bergwerke von Serbien und Bosnien während des Mittelalters*. Historisch-geographische Studien von Dr. Constantin Jos. Jireček. Prag: K. Böhmische Gesellschaft der Wissenschaften 1879, f. 22.

⁵ M. Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens ...*, f. 25.

⁶ Theodor Ippen, “Denkmäler verschiedener Altersstufen in Albanien”, në *Wissenschaftliche Mitteilungen aus Bosnien und Herzegovina*. Herausgegeben von Bosnisch-Herzegowinischen Landesmuseum in Sarajevo. Redigiert von Dr. Moriz Hoernes. *Zehnter Band*. Mit 11 Tafeln, 214 Abbildungen im Texte und 5 Stammtafeln. Wien: Adolf Holzhausen 1907, f. 6.

Lezha të cilat, bënin pjesë në këtë provincë mundën t'i bënin ballë këtyre sulmeve.⁷

Megjithatë pas këtij shkatërrimi Baleci u ringrit përsëri, pasi pas periudhës së mësymjes së avarëve përmenden ipeshkvijtë e dioqezës së Balcit (Palachiensis ose Balleacensis)⁸.

Por, prapëseprapë historia e tij gjatë periudhës së Mesjetës së Hershme është e errët, pasi nuk gjejmë kurrfarë të dhënash të tjera.

Ky lokalitet që sot nuk i ekzistojnë më as gërmadhat, ndodhet disa kilometra në afërsi të Shkodrës dhe, në afërsi të fshatit Kurte (Kurtaj) rreth 1 orë larg nga Shkodra, duke pasur parasysht që një pjesë e madhe e rrugës ngaqë është e vështirë duhet të bëhet me këmbë edhe sot. Barleti e jep largësinë e tij nga qytetet e tjera si 12 mijë hapa larg nga Shkodra, 5 mijë hapa nga Drishti dhe 15 mijë hapa nga Deja.⁹

Qyteti shtrihej mbi një kodër, poshtë së cilës rrjedhin lumi i *Rrjollit*, dhe *Përroi i Kurtës* (ose *Gurra e Kurtit* siç e gjejmë tek Ippeni¹⁰). Kodra gjendet pikërisht në pikën ku lumi i Rrjollit që vjen nga Alpet e Parunit takohet me këtë përrua që buron diku në bjeshkët e Bishkasit.¹¹ Perimetri i mureve të kështjellës, sipas Shuflajt, ishte rreth 1000 hapa, pra



Fig. 2: Rrënoja muresh në Balec.
Foto: Th. Ippen, "Denkmäler...", f. 8.

⁷ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI-vitet 20 të shek. XIX), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002, f. 205-206.

⁸ Th. Ippen, "Denkmäler verschiedener Altersstufen ...", f. 6.

⁹ Marin Barleti, *Historia e Skënderbeut*, përkthyer nga Stefan J. Prifti, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë: 1964, f. 152.

¹⁰ Th. Ippen, "Denkmäler verschiedener Altersstufen...", f. 6.

¹¹ Theodor A. Ippen, *Die Gebirge des Nordwestlichen Albaniens*. Abhandlungen der K. K. Geographischen Gesellschaft in Wien. VII. Band, 1908, N° 1. Wien: Lechner/Müller 1908, f. 18.

korrespondon me gjysmën e perimetrit të kështjellës së Shkodrës, pra mund të konsiderohet si qytet i vogël.¹²

Pra, zona edhe në Mesjetë nuk ka pasur mungesë uji pasi Rrjollli në stinën e verës ka prurje të mjaftueshme. Rrjollli etimologjikisht rrjedh nga fjala latine *rivulus* që do të thotë *rrjedhë*, kurse Gurra e Kurtit, duhet ta ketë marrë emrin nga fshati Kurte, pranë të cilit rrjedh ky lum.¹³ Nga vizita që i bëra kësaj kodre nuk munda të evidentoj asnjë rrënojë përveç disa gjurmë muresh të vjetra, të cilat janë rrafsh me sipërfaqen. Maja e kodrës është e mbuluar me shkurre e ferra të dendura, të padepërtueshme, dhe pikërisht brenda këtyre shkurreve duhet të ndodhet akoma ndonjë rrënojë e *Balezos* mesjetare.




Fig. 3: Mure ndërtesash të vjetra nën kodër të Balezit.
Foto: E. Malaj 2012.

Megjithatë, në kohë më të hershme, rreth 100 vjet më parë këto rrënoja ishin më të evidentueshme dhe autorë të ndryshëm na raportojnë mbi to si për shembull Jastrebovi në përshkrimin e tij, thotë se perimetri i zonës së këtyre rrënojave është sa gjysma e kalasë së Shkodrës dhe se këto rrënoja, tek të cilat mund të dallohen

mbetjet e një kiske të madhe dhe të një tjetre më të vogël, janë të mbuluara nga shkurret.¹⁴ Sipas Ippen-it, perimetri i majës së kodrës është i gjerë 1000 hapa; midis shkurreve mund të dallohen gërmadhat e mureve të këtij qyteti dhe rrënojat e një kiske, porse këto rrënoja janë në një

¹² M. Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens...*, f. 25.

¹³ Th. Ippen, *Die Gebirge des Nordwestlichen...*, f. 18.

¹⁴ Konstantin Jireček, "Skutari und sein Gebiet im Mittelalter", në *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček [u. a.]. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 100.

gjendje më të mjeruar sesa ato të Svaçit, Sardës apo të Drishtit (Drivastit).¹⁵

Megjithëse i vogël si qytet¹⁶, Baleci duhet të ketë pasur një jetë të zhvilluar. Në librat e Arkivit të Raguzës përmenden zejtarë nga ky qytet, që ishin punues të drurit (marangoni), këpucëbërës (cerdoni).¹⁷ Një nga këta është edhe Dobroslavi nga Baleci (*Dubroslaus de Ballegio, cerdo castaldio fratilie sancti domani*), i cili ishte lëkurëpunues dhe agjent i “Vëllazërisë së Shën Domanit [Damianit – E.M.]” dhe del i dokumentuar në Raguzë më 20 mars 1402, në lidhje me një shpërndarje testamentare, nga e cila kishte përfituar dy perperë për llogari të vëllazërisë së sipërpërmendur.¹⁸ Dobroslavi, krahas dom Pellegrinit, është personi më i dokumentuar i Balecit, pasi emri i tij përmendet në disa dokumente, ai ishte i vëllai i dom Benkut¹⁹, klerik dominikan, për të cilin do të flitet në pjesën e dytë të këtij artikulli. Dobroslavi nga Baleci shfaqet edhe në një dokument në lidhje me shlyerjen e detyrimit për disa mallra të marra, nga dy fisnikë shkodranë Stefan dhe Pjetër de Roza.²⁰

Ngaqë bëhet fjalë për marrëdhënie profesionale dhe tregtare midis qytetarësh nga Baleci dhe Shkodra, dy qytete që ishin vetëm disa kilometra larg nga njëri-tjetri, e shohim të arsyeshme që ta japim të plotë dokumentin në fjalë:

“Dita e 22 shkurtit [1403]. Stefan de Roza, qytetar fisnik shkodran prokurator dhe në emër të prokuratorisë së zotit Jakob de Roza, vëllait të tij, siç del ky i tillë prokuracion nga letrat e patentave të gjykatësve dhe këshilltarëve të qytetit të Shkodrës, të lëshuara me gjurmën e vulës së tyre të dukshme në dyll të kuq, sipas mënyrës së një qyteti, më 23 janar njëmijë e katërqind e tre dhe të para e të lexuara prej meje, noter Jakobi i poshtëshënuar. [Stefani] në emër të prokuratorisë së thënë dëshmoi se, po në atë emër iu bë pagesa dhe mbeti plotësisht i kënaqur për të gjitha dhe për çdo gjë që Dobroslavi nga Balëza, këpucar në Raguzë, i detyronte zotit

¹⁵ Th. Ippen, “Denkmäler verschiedener Altersstufen...”, f. 9.

¹⁶ M. Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens ...*, f. 25.

¹⁷ K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet ...”, f. 101.

¹⁸ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV..., I (1400-1405)*, nr. 204.

¹⁹ *Po aty*, nr. 306.

²⁰ *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia* (më tej: AAlb). Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen II (Annos 1344-1406 continens Vindobonae MXXVIII. Typis Adophi Holzhausen, nr. 716.

Stefan dhe atij Jakobi, prokurator, për disa mallra të marra tek ata në Shkodër, dhe për vete dhe në emër [të vëllait] i bëri Dobroslavit në fjalë dëshmi e siguri të plotë se ka marrë fund, është paguar dhe shlyer çdo gjë, me kusht që më tutje nuk do të kërkojnë gjëkafshë prej Dobroslavit në fjalë apo prej trashëgimtarëve të tij.”²¹

Dobroslavi mesa duket ishte një mjeshtër i njohur në profesionin e këpucarit, pasi nëpër dokumente shfaqen edhe nxënës (çirakë) të cilët kishin shkuar për të punuar dhe për të mësuar zanatin tek ai. Një rast i tillë ishte edhe Radoslavi, i biri i Dobrosh Obradoviçit nga Mali i Zi (*Radoslaus condam dobrosij Hobraouich de cernagora*), i cili në moshën katërmëdhjetë vjeç pajtohet si çirak tek mjeshtri nga Baleci, për të nxënë zanatin e këpucarisë dhe për t'i shërbyer besnikërisht dhe ndershmërisht e për të punuar për gjashtë vitet e ardhshme.²²

Mjeshtri, nga ana e tij, i premtonte djaloshit katërmëdhjetëvjeçar se do t'i hiqte shpenzimet e ushqimit dhe të veshjes në mënyrë të përshtatshme, qoftë gjatë kohës kur ai ishte shëndoshë, qoftë në ditët kur ai ishte i sëmurë dhe se do t'i mësonte zanatin e këpucarisë deri në afatin e vendosur në marrëveshje. Pas përfundimit të këtij afati, atëherë mjeshtri do ta pajiste çirakun e vet me veglat që i nevojiteshin për ushtrimin e profesionit.²³ Ky dokument i datës 30 dhjetor 1404²⁴, është një kontratë e bërë midis një mjeshtri dhe çirakut të tij dhe ka rëndësi të madhe pasi na jep disa detaje nga bota e esnafëve dhe e korporatave mesjetare, në lidhje me marrëdhëniet midis mjeshtërve dhe çirakëve dhe detyrimeve që ata kishin kundrejt njëri-tjetrit.

Përsa i përket marangozëve, kemi të dokumentuar Palin nga Baleci (*Paulus de Ballegio marangono*), i cili shfaqet nëpër dokumente disa herë. Në vitin 1388, ai përmendet së bashku me ndihmësin e tij, Jurglio Braikoviç de Koruzi nga Shqipëria (*Jurglio Braychovich de Choruçi Albanie*)²⁵, e gjejmë edhe në një dokument të vitit 1398²⁶ dhe së fundi përmendet edhe në një testament raguzan të datës 10 qershor 1402.²⁷

²¹ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV ..., I (1400-1405)*, nr. 302.

²² *Po aty*, nr. 480.

²³ Për sqarim shih: *po aty*, nr. 446, shën. 3, f. 510.

²⁴ *Po aty*, nr. 480.

²⁵ AAlb II, nr. 434.

²⁶ *Paulus Marangonus de Balezio Ragusii memoratus 1398, 1. Aprilis [Div. Canc. 1396-1399]*). AAlb II, nr. 434.

²⁷ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV..., I (1400-1405)*, nr. 223.

Përsa i përket ekonomisë me rëndësi për qytetin duhet të ketë qenë lumi i Rrjollit që rrjedh poshtë tij. Ky lum ka pasur dhe ka peshk sidomos trofta dhe lugina që krijon ai (lugina e Rrjollit) duke qenë e mbrojtur nga malet kishte një klimë të butë ku mund të zhvillohet bujqësia, pemëtaria, vreshtaria dhe blegtoria.²⁸ Nga ana tjetër, duke qenë në afërsi të krahinës së Koplikut që njihej në mesjetë si vend vreshtash dhe duke pasur në afërsi edhe fisin e Shkrelit, i cili njihej si fis barinjsh gjysmënomad, që veronte bagëtitë në bjeshkë dhe i dimëronte ato në fushat në afërsi të Shkodrës dhe pranë bregdetit, sidomos në Velipojë, duke përdorur si udhë shtratin e Prronit të Thatë në afërsi, Baleci me siguri duhet të ketë qenë patjetër një pikë për grumbullimin e verës, leshit, lëkurëve dhe të produkteve të tjera blegtorale.

Lumi i Rrjollit ka pasur për Balecin dhe krahinat përreth edhe një rëndësi tjetër të madhe. Në të kishte shumë mullinj, njëri nga të cilët i përkiste ipeshkvit të këtij qyteti, kurse një tjetër, sipas një dokumenti venedikas të datës 27 mars 1417, muratorit Gjoni (*Johannes murarius*) nga Shkodra, mulliri i të cilit ndodhej poshtë mullirit të ipeshkvit.²⁹ Ekzistenca e shumë mullinjve dëshmon fluksin e madh të drithit që ka pasur ky vend në Mesjetë. Për zhvillimin kulturor dhe fetar, përveç kishave të qytetit, duhet të ketë luajtur një rol të rëndësishëm edhe Manastiri i Shën Gjonit në Fushën e Shtojit, i cili dikur i përkiste pikërisht ipeshkvisë së Balecit.

Qyteti duket si filloi të zvogëlohej e të humbiste rëndësinë e tij aty nga gjysma e shek. XIV, ose sipas Ippenit edhe më përpara³⁰. Në fillim të shek. XV territori i këtij qyteti ishte kthyer në pronia dhe në vitin 1404 përmendet si një ndër proniarët e Balecit, Radiq Humoi (*Raducius*

²⁸ O. Schmitt, *Das venezianische Albanien...*, f. 97.

²⁹ *Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV*. Josephi Valentini S. J. Labore reperta et Transcripta Ac Typis Mandata. Tomi (Vol.) 1-25. Palermo/ Napoli/ Roma/ Venezia/ München: Archivio di Stato di Venezia 1967-1972 (më tej: AAV, vol., dok.): “[...]secundum antiquam consuetudinem patriae Insuper concedimus Jpsi Johannj et eius heredibus quod ipse Johannes et eius heredes fabricare et construere possit unum molendium in flumaria rirole subius molendinum domini epsicopi de Balezo”. AAV VIII, nr. 2156.

³⁰ Ippen është i mendimit se qyteti duhet të ketë pushuar së ekzistuar aty rreth mesit të shek. XIV dhe në vitin 1448 kishte mbetur vetëm kujtimi rreth tij. Th. Ippen, “Denkmäler verschiedener Altersstufen...”, f. 6.

Homoy).³¹ Sipas Kadastrës 1416-1417, “qyteti i Balezos” (“Cità di Balezos”) numëronte në atë kohë rreth 25 shtëpi,³² pra, tashmë ishte kthyer në një fshat. Nga kjo kadastrë përmenden disa banorë të këtij qyteti me krrerët dhe pronarët e pronave dhe të fshatrave përreth. Kreu i këtij “qyteti” gjatë kohës kur u përpilua kadastra duhet të ketë qenë Andrea Humoj, kurse si pronar përmendet, Kojaçini, i biri i të ndjerit Radiq. Kurse, banorët e regjistruar në kadastrë janë emrat si më poshtë, të transkriptuara në shqip dhe në origjinal:

Domenik Molasiri, urdhërues (*domenego molasirj, comandadore*) që ishte i çliruar nga të gjitha pagesat, më tej, Martin Kavaljero (*Martin Cauliero*), Zuan Juani (Ivani) (*Zuane Yuan*), Martin Felipi (*Martin Felipo*), Zuan Tuzi (*Zuan Tusi*), Stefan Molasira (*Stefano Molasire*),



Fig. 4: *Fragmente nga muret e Balezit sot.*
Foto: E. Malaj 2012.

Progan Paruçi (*Progano Paruci*), Benko Albuçi (*Benco Albuçi*), Dom Petro Juani (Ivani) (*don Petro Yuan*), Petro Prekali (*Petro Precalji*), Dhimitër Kakarriqi (*Dimitrij Cacharichi*), Dom Petro Andrea (*Don Pedro Andrea*), Dom Lazër Salamon (*Lazaro Salamon*), Petro Madoshi (Madhoshi) (*Petro Madossi*), Zor-

zi Madoshi (Madhosi) (*Zordi Madossi*), Domenik Felipi (*Domenego Felipo*), Dom Andrea Gregolo (*Don Andria Gregolo*), Dom Zuane Sergani (*Don Zane Sergano*), Martin Rajku, (*Martin Rayco*), Zuan Zoku (Coku) (*Zane Zocho*), Mjeshtëri Palushi (murator) (*Mastro Polusso Muraro*), Andrea Leporoshi (*Andrea Leporonsi*), Dom Petro Katoci (*Don*

³¹ AAlb II, nr. 752.

³² *Regjistri i Kadastrës dhe i Koncesioneve për rrethin e Shkodrës (1416-1417)*, përgatitur për botim nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1977, f. 69-70; 293-294 (57a).

Petro Catozi), Dom Domenik Ungreshe (*Don Domenego Ungresse*) dhe Dom Progan Progani (*Don Progano Proganj*).³³

Këta qytetarë duhej të paguanin të gjithë nga një *dukat* dhe pjesa më e madhe e tyre nga një *mod*; taksat e orokut me nga katër grosh për shtëpi, dy herë në vit, për Krishtlindje dhe për Pashkë, si dhe ishin të detyruar që të bënin shërbim ushtarak si këmbësorë apo si kalorës, në rast se këtë e urdhëronin rektorët e Shkodrës.³⁴ Vërehen këtu mbiemra familjarë që i gjejmë në shumë lokalitete të tjera të Shkodrës si dhe në Drisht dhe shumica e këtyre mbiemrave janë shqiptarë. Krahas këtyre banorëve qytetarë nga Balezo hasim edhe në zona të tjera të Shkodrës si p. sh. dom Pjetri nga Baleci (*don Piero da balezo*) që kishte marrë me qira një copë tokë tek Kazenet e Shkodrës.³⁵ Porse, pak kohë më vonë, ky qytet gjendej i shkretuar plotësisht.³⁶

Qyteti kishte edhe shumë fshatra, të cilat jepen në kadastër me përcaktimin *nën Balecin*, të cilat në Mesjetë duhet të kenë pasur pikërisht Balecin si qendër administrative dhe kishtare.³⁷ Pra, dikur qyteti duhet të ketë qenë një qendër me shumë prona dhe fshatra përreth duke qenë kështu lokaliteti kryesor në luginën e Rrjollit. Këto fshatra janë Zakoli në Balecin (*Zacholj soto balezo*) me tri shtëpi³⁸, Braza nën Balecin (*Braza soto balezo*) me pesë shtëpi³⁹, Dari nën Balecin (*darj soto balezo*) me njëmbëdhjetë shtëpi⁴⁰, Leporoshi nën Balecin (*Leporonsi soto balezo*) me shtatë shtëpi⁴¹, Shën Aleksandri nën Balecin (*sancto Alexandro soto balezo*) që në atë kohë ishte i braktisur dhe i pabanuar⁴², Zamaraki nën Balecin (*zamarachi soto balezo*) që kishte tri shtëpi⁴³ dhe fshati i braktisur i Brokulkut (*Villa clamada Brochulcho e desabitada*)⁴⁴.

³³ AAV VIII, nr. 2107/48; Rregjistri i Kadastrës, f. 69-70; 293-294 (57a).

³⁴ AAV VIII, nr. 2107/48; Rregjistri i Kadastrës, f. 70. (57a)

³⁵ *Regjistri i Kadastrës dhe i Koncesioneve...*, f. 26. (6 ab)

³⁶ K. Jireček, "Skutari und sein Gebiet...", f. 101.

³⁷ O. Schmitt, *Das venezianische Albanien...*, f. 97.

³⁸ AAV VIII, nr. 2107/49.

³⁹ AAV VIII, nr. 2107/51.

⁴⁰ AAV VIII, nr. 2107/52.

⁴¹ AAV VIII, nr. 2107/53.

⁴² AAV VIII, nr. 2107/54.

⁴³ AAV VIII, nr. 2107/57.

⁴⁴ AAV VIII, nr. 2107/50.

Siç e pamë edhe më sipër, këto fshatra, porsì vetë qyteti, ishin të banuara në atë kohë nga pak banorë (nga tre deri në dhjetë familje), bile midis tyre kishte edhe ndonjë krejtësisht të braktisur siç ishte Brokolku dhe Shën Aleksandri nën Balecin, i cili duhet të ketë qenë pikërisht nën kodrën e qytetit.⁴⁵

Ivan Crnojeviqi, princi i Malit të Zi i njofton venecianët në vitin 1474, se turqit donin ta fortifikonin këtë qytet përsëri,⁴⁶ por ky qëllim i tyre, mbeti i parealizuar.⁴⁷ Barleti, i cili ishte nga Shkoda dhe që duket qartë e njihje mirë zonën përreth qytetit të tij, përmend këtë lokalitet si një gjermadhë që ndodhet 12 milje romake larg Shkodrës dhe 5 milje romake larg Drishtit.⁴⁸

Në Balec ishte katedralja e Shën Mërisë, dhe në afërsi të tij ishte manastiri i Shën Gjonit me kambanare shumë të lartë me gurë të gdhendur. Ky kuvend i vjetër, i cili në fillim ishte benediktin, lidhet pastaj me ipeshkvinë e Drishtit, nga e cila më vonë dilte edhe abati i këtij manastiri (1442) (*Semper in Futurum abbas sit Drivastinus*).⁴⁹ Përveç tyre është e dokumentuar edhe një kishë tjetër dedikuar Shën Lleshit, që shkruhet se ka qenë nën Balec “*Sancto Alexandro sotto Balezio*”.⁵⁰

Në këtë qytet ka qenë i pranishëm me luftëtarët e tij edhe Skënderbeu, i cili duhet të ketë bërë ndonjë rindërtim të kështjellës aty nga vitet 1447-1448, kur ai pati mosmarrëveshje me venedikasit, në lidhje me zotërimin mbi qytetin e Dejës⁵¹. Pas vdekjes së Lekë Zaharisë

⁴⁵ *Regjistri i Kadastrës dhe i Koncesioneve...*, f. 70-71. (57b, 58a, 58b, 59a)

⁴⁶ K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet...”, f. 101.

⁴⁷ M. Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens...*, f. 25.

⁴⁸ K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet...”, f. 101.

⁴⁹ *Statutet dhe Urdhëresat e Kapitullit të Kishës Katedrale të Drishtit* (Statuta et Ordinationes Capituli Ecclesiae Cathedralis Drivastensis), përgatitur nga Musa Ahmeti, Etleva Lala, Tiranë: OMBRA GVG, 2009, f. 55-56.

⁵⁰ *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen I (Annos 344-1343 tabelamque geographicam continens) Vindobonae MXMXVIII. Typis Adophi Holzhausen, nr. 653, shën.1; Shih edhe: Konstandin Jireček, “Das christliche Element in der topographischen Nomenclatur der Balkanländer”, në *Sitzungsberichte der Philosophisch-Historische Classe*, nr. CXXXVI (1897), f. 20.

⁵¹ Th. Ippen, “Denkmäler verschiedener Altersstufen...”, f. 6.

Skënderbeu ia dha për administrim Pal Dukagjinit,⁵² i cili ashtu si vetë Lekë Zaharia ishte anëtar i Lidhjes së Lezhës, të themeluar nga Skënderbeu, më 2 mars 1444.⁵³ Në këtë lidhje morën pjesë Pjetër Shpani me të katër bijtë Aleksin, Bozhdarin, Vruon, Mirkon dhe Lekë Dushmani,⁵⁴ që kishte nën zotërim prona rreth Drishtit, Balcit dhe në Zadrimë.⁵⁵ Venedikasit ishin kundër Lidhjes së Lezhës, e cila kërcënonte posedimet e saj në veri. Gjatë kësaj kohe midis Skënderbeut dhe Venedikut mosmarrëveshjet u thelluan aq shumë sa që në muajin dhjetor të vitit 1447 midis tyre shpërtheu një konflikt.⁵⁶

Fisnikët drishtjanë, Pjetër Shpani me të bijtë dhe Lekë Dushmani, që nuk ishin të gatshëm të pranonin dhe të merrnin pjesë në veprimet armiqësore të Skënderbeut kundër Venedikut, dolën nga Lidhja.⁵⁷ Ky veprim mund të ketë qenë edhe një shkas më tepër, që Skënderbeu pasi theu forcat e guvernatorit të Shkodrës, Daniele Luriki më 23 korrik 1448,⁵⁸ rrezikoi edhe pushtimin e Drishtit.⁵⁹ Në zonat e Shkodrës kishte ardhur një ushtri e konsiderueshme e Skënderbeut, i cili gjatë kësaj kohe rindërton edhe kështjellën e Balcit për ta pasur si pikë mbështetjeje për këto sulme.⁶⁰

Sot nuk jemi në gjendje të lokalizojmë, se në çfarë vendi tek kodra e Balcit, i ka bërë Skënderbeu fortifikimet. Po ashtu edhe Ippen, i cili mbi 100 vjet më parë konstaton rrënoja më shumë sesa ne sot, nuk është në gjendje të bëjë lokalizimin e kështjellës së Skënderbeut mbi Balc.⁶¹ Më vonë gjatë rrethimit të parë të Shkodrës qytezën e përdorën kundër këtij

⁵² Branislav Millutinoviç, “Drishti nën sundimin e Venedikut”, në *Gjurmime Albanologjike*, Seria e shkencave historike, 15-1985, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë: 1986, f. 59.

⁵³ M. Barleti, *Historia e Skënderbeut ...*, f. 93; shih edhe: Kristo Frashëri, *Skënderbeu. Jeta dhe Vepra (1405-1468)*, Tiranë: Toena, ²⁰⁰², f. 136.

⁵⁴ M. Barleti, *Historia e Skënderbeut ...*, f. 94.

⁵⁵ Edmond Malaj, *Historia dhe fizionomia e një qyteti mesjetar shqiptar - Drishti*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2016, f. 96.

⁵⁶ B. Millutinoviç, “Drishti nën sundimin ...”, f. 59.

⁵⁷ E. Malaj, *Historia dhe fizionomia e një qyteti ...*, f. 96; Virgjil Kule, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu – kryqtari i fundit*, Tiranë: Ombra-GVG, 2011, f. 100.

⁵⁸ Po aty, f. 112.

⁵⁹ B. Millutinoviç, “Drishti nën sundimin ...”, f. 59.

⁶⁰ E. Malaj, *Historia dhe fizionomia e një qyteti ...*, f. 96.

⁶¹ Th. Ippen, “Denkmäler verschiedener Altersstufen ...”, f. 6.

qyteti edhe osmanët.⁶² Mbi ndonjë rikonstrukcion të kështjellës së Balcit nga ana e Turqve gjatë kësaj kohe nuk kemi të dhëna tani për tani.

Të dhëna rreth dioqezës mesjetare të Balcit

Ky qytet kishte ipeshkvinë e vet (*Ecclesia Balleacensis* ose *Palachiensis*) dhe ipeshkvi (*Episcopus Balleacensis*) ishte nën juridiksionin e kryepeshkvit të Tivarit.⁶³ Por qysh në vitin 1356, ipeshkvi i këtij qyteti ankohej sepse nuk kishte të ardhura, ngaqë krahina e dioqezës së tij ishte plot me skizmatikë (ortodoksë).⁶⁴

Shkaku i përqendrimit të ortodoksëve në këtë zonë mund të ketë qenë afërsia e fshatit *Cupelnich* (sot Koplík dhe në Kadastrën venedikase të vitit 1416 i njohur me emrin *Kopeniko*), i cili sipas kësaj kadastrë rezultoi i banuar nga një shumicë banorësh sllavë dhe nga shumë priftërinj të kishës sllave si Jura i Protopopit, popi Andrea, popi Nikashin (Nikašin), popi Milica (Miliza), popi Stanko, popi Bogdan, popi Radoslav Tribov, popi Radovani etj.⁶⁵ Megjithatë, siç e pamë edhe më sipër në kadastrë shfaqen edhe priftërinj katolikë të cilët janë Dom Petro Katoci (*don petro catozi*), Dom Domenik Ungreshe (*don domenego ungresse*) Dom Progan Progani (*don progano proganj*), Dom Petro Andrea (*don pedro Andrea*), Dom Lazër Salamoni (*lazaro salamon*), Dom Andrea Gregolo (*don andria gregolo*), Dom Zuane Sergani (*don zane sergano*), dhe Dom Petro Juani (Ivani) (*don petro yuan*).⁶⁶

Ipeshkvi i Balcit përmendet për herë të parë në një shkresë të Papës Aleksandër II në vitin 1062 drejtuar Pjetrit, argjipeshkvit të Tivarit,

⁶² ASV Senato Secreta Reg. 26. 189r “*quendam alium locum inter Ciuitates nostras Scutari et driuastum nomine Bales*” dokumenti i cituar nga O. Schmitt, *Das venezianische Albanien...*, f. 97.

⁶³ *Illyrici Sacri. Tomus Septimus, Ecclesia Diocletiana, Antibarensis, Dyrrhachiensis et Sirmiensis, cum eorum suffraganeis*. Auctore Daniele Farlato, Presbytero Societatis Jesu, et Jacobo Coletto olim ejusdem Societatis alumno. Venetiis, MDCCCXVII. Aput Sebastianum Coleti. Superiorem permissu ac privilegio. (Botim i dytë. Prishtinë: Arbi 2004.), f. 206. K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet ...”, f. 100.

⁶⁴ K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet ...”, f. 100.

⁶⁵ Po aty, f. 101.

⁶⁶ AAV VIII, nr. 2107; *Regjistri i Kadastrës dhe i Koncesioneve...*, f. 69-70; 293-294 (57a); O. Schmitt, *Das venezianische Albanien...*, f. 96.

sufragane e të cilit ishte edhe dioqeza e Balecit.⁶⁷ Megjithatë, personalisht me emër ipeshkvijtë e Balecit fillojnë të përmenden që në shek. XV, që janë:

I. Guljelmi (*Gullielmus Episcopus Balleacensi*) është ipeshkvi i parë i dokumentuar i Balecit i cili njihet me emër dhe përmendet në një letër të Papë Klementit VI, të cilin ai në mars të vitit 1347 ja drejton atit françeskan Gervikut, duke e emëruar atë ipeshkëv të Balecit, pasi Guljelmi tashmë kishte vdekur.⁶⁸ Se cilit urdhër i përkiste Guljelmi këtë nuk e mësojmë. Gjithashtu nuk dihet se kur u bë ipeshkëv i Balecit. Mendojmë se ai ishte françeskan. Pothuajse të gjithë ipeshkvijtë i përkisnin këtij urdhri.

II. Pra në vitin 1347, Gjerviku (*Gervicus Episcopus Balleacensi*) françeskan bëhet ipeshkëv i Balecit. Ai vdes në vitin 1351.⁶⁹

III. Në vitin 1351, pas vdekjes së Gjervikut bëhet ipeshkëv i Drishtit *Andreas Citer* që i përkiste gjithashtu Urdhrit Françeskan.⁷⁰

IV. *Emri i ipeshkvit anonim*. Pas Andreas, ipeshkvi i radhës është anonim dhe përmendet pa emër vetëm në një dokument të vitit 1363 që është një testament i një kleriku me emrin Don Pellegrini, i cili mesa duket ishte nga Baleci, pasi i lë trashëgimi disa objekte personave në Balec, ku në mesin e tyre ishte edhe vetë mbesa e testamentarit (*a la mia neça Cutha*). Kishës së Shën Mërisë së Balecit ai i lë 12 krahë pëlhurë fine (*braça XII di tela sutile*) kurse vetë ipeshkvit të Balecit një popal prej bakri (*bocalo di rame sia dado alo veschouo di Baleç*).⁷¹

V. Gjoni, ipeshkëv i Balecit (*Johannes, Episcopus Baleazencis*) përmendet në një dokument të 4 qershorit 1383 në lidhje me marrjen e një kaucioni.⁷²

VI. *Emri i ipeshkvit anonim*. Në vitit 1391 ipeshkvi i Balecit përmendet edhe në një dekret të dërguar nga papa Banifai IX kundër fretërve të urdhrave lypsarë (*fratres ordinis mendicantium*). Aty

⁶⁷ Th. Ippen, "Denkmäler verschiedener Altersstufen ...", f. 7.

⁶⁸ D. Farlati, *Illyricum Sacrum VII...*, f. 207.

⁶⁹ AAlb II, nr. 85.

⁷⁰ "(1351), 1 iunii. Apud Villam novam. Clemens VI. Papa Andream Citer electum Balazensem ordinis Minoris eidem ecclesie "per obitum Gervoco, qui nuper extra Romanam curiam diem clausit extremum", vacant episcopum praefecit." AAlb II, nr. 85.

⁷¹ AAlb II, nr. 188.

⁷² AAlb II, nr. 383.

përmenden edhe kryepeshkvi i Shkodrës me ipeshkvijtë e Drishtit, të Pultit, por emri i ipeshkvit të Balcit nuk përmendet.⁷³ Jemi të mendimit që ipeshkëv duhet të ketë qenë akoma Gjoni i lartpërmendur, pasi distanca kohore nuk është shumë e largët. Megjithatë nuk përjashtohet mundësia, që mund të ketë qenë ipeshkëv edhe ndokush tjetër. Në vitin 1404 ipeshkvi i Balcit përmendet sërish pa emër në lidhje me proniat në Balc që i kishte një fisnik shkodran i quajtur Radicus Humoi, por edhe në këtë dokument emri i ipeshkvit nuk përmendet.⁷⁴

VII. Në vitin 1420 ipeshkëv bëhet *Alfonso da Cáceres* ose *Cavres*, i cili i përkiste Urdhrit Françeskan Minorit (O.F.M.). Rezulton si ipeshkëv i Balcit që prej datës 7 prill 1420.⁷⁵ Deri kur qëndroi me këtë titull, këtë nuk e dimë.

VIII. Në vitin 1422 rezulton si ipeshkëv *Domenico Godani*. Ai ishte ipeshkëv i Balcit që prej datës 6 prill 1422 – ?.

IX. 1424 *Mikel Paoli*, Paulluz ose de Paolis nga Villa, i dioqezës së Trevizit, françeskan. Ipeshkëv i Balcit ishte gjatë periudhës 1 shtator 1424-11 tetor 1428, kurse më vonë u bë ipeshkëv i Drishtit⁷⁶ gjatë periudhës 11 tetor 1428 - 1445 (?). Vdiq në vitin 1445.

X. 1428, *Bernardi de Ivanis* ose de Vivanis (ose *Bernardo da Viviers*, O.F.M.) prej Drishtit, françeskan. Ipeshkëv i Balcit gjatë periudhës 11 mars 1428 – 1459 (?). Vdiq në vitin 1459.⁷⁷

XI. 1459 *Leonardo da Napoli*, napolitan me origjinë. Ai i përkiste Urdhrit Dominikan (O.P), dhe rezulton si ipeshkëv i Balcit gjatë periudhës (08.31.1459– ?).⁷⁸

XII. Nga viti 1478 në ipeshkvinë e Balcit kemi ipeshkvij titullarë të cilët fillojnë me klerikun françeskan *Daniel Zahender*.⁷⁹

XIII. *Leonardo* (? –30. 7. 1488), ipeshkëv titullar i Balcit deri më 7. 30. 1488) pastaj u bë ipeshkëv i Lesinës (30 korrik 1488 – ?).

Duke pasur parasysh pasaktësitë, sipas F. Kordinjanos numërohen gjithsej 13 ipeshkvij të Balcit,⁸⁰ të cilët i përkasin periudhës së Mesjetës.

⁷³ AA1b II, nr. 470.

⁷⁴ AA1b II, nr. 752.

⁷⁵ D. Farlati, *Illyricum Sacrum VII...*, f. 207.

⁷⁶ *Po aty*.

⁷⁷ *Po aty*.

⁷⁸ *Po aty*, f. 208.

⁷⁹ Th. Ippen, “Denkmäler verschiedener Altersstufen ...”, f. 9; shih edhe: D. Farlati, *Illyricum Sacrum VII...*, f. 207.

Në listën e sipërme arritëm të paraqesim vetëm 11 prej tyre me emër dhe dy të tjerë anonimë. Sot ipeshkvia e Balecit është titullare dhe numëron shtatë ipeshkvi titullar që nga gjysma e parë e shek. XX deri në ditët e sotme.⁸¹

Krahas ipeshkvi, nëpër dokumente të ndryshme hasim edhe klerikë të tjerë që janë nga ky qytet.

Këtu mund të përmendim së pari dom Andrenë dhe diakonin Stefan që të dy nga Baleci të cilët kanë ushtruar aktivitetin e tyre në gjysmën e parë të shek. XIV dhe janë të dokumentuar në Raguzë në mars të vitit 1349.⁸² Në vitin 1363, përmendet dom Zorzi (dom Çorço), i cili jetonte në Balc dikur në afërsi të portës së Kishës së Shën Kollit të Balecit.⁸³ Këtij, dom Pellegrini i lë me testament disa objekte. Dom Pelegrini nga Baleci haset gjithashtu edhe në një dokument të vitit 1349. Ai ishte një nga priftërinjtë që shkonte në pelegrinazh për shpirtin e besimtarëve tashmë të vdekur duke u paguar për këtë nga familjarët e të ndjerëve. Më 23 maj 1349, pas murtajës së madhe që kishte pllakosur në zonat e Republikës së Raguzës dhe në vende të tjera të Ballkanit, dom Pelegrini i Balecit deklaroi se kishte marrë nga Pashka de Sorigo (*Pascha de Sorigo*)

⁸⁰ Fulvio Kordinjano, *Shqipëria. Përmes veprës dhe shkrimeve të misionarit të madh italian At Domeniko Pazi (1847-1914)*, vëll. II (Betejat e trekëndëshit gjigant katolik të veriut Shkodra-Pulati-Shkupi), përktheu nga origjinali Ilirjana Angoni, Tiranë: Almera, 2008, f. 33.

⁸¹ Ipeshkëv titullar (24.01.2014 - ...) *Herwig Gössl* (49) njëkohësisht edhe ipeshkëv ndihmës i Bambergut (Gjermani); *Franz Lackner*, O.F.M. (60), (më vonë arqipeshkëv) ipeshkëv titullar i Balecit gjatë periudhës 23.10.2002-18.11.2013; *Peter Kang U-il* (70) ipeshkëv titullar i Balecit gjatë periudhës 21.12.1985-20.07.2002; *Claude Feidt* (80), ipeshkëv titullar i Balecit gjatë periudhës 05.07.1980-16.02.1985 (më vonë argjipeshkëv); *Amaury Castanho*, ipeshkëv titullar i Balecit gjatë periudhës 19.07.1976-30.11.1979; *Agostino Baroni*, M.C.C.J. (më vonë argjipeshkëv), ipeshkëv titullar i Balecit gjatë periudhës 29.06.1953-12.12.1974; *Johannes Theodor Suhr*, O.S.B., ipeshkëv titullar i Balecit gjatë periudhës 13.12.1938-29.04.1953. Titular Episcopal See of Balcium Albania. URL: <http://www.gcatholic.org/dioceses/former/t0266.htm> (8. 11.2016) te kjo faqe shih edhe në lidhje me ipeshkvi të e përmendura më sipër *Alfonso da Cáceres* ose *Cavres*, *Domenico Godani*, *Mikel Paoli* dhe *Leonardo*.

⁸² AAII, nr. 50.

⁸³ AAII, nr. 188.

10 hyperperë, me qëllim që të shkojë në Shën Françesk të Asizit për shpirtin e Stepes, babait të Pashkës.⁸⁴

Dom Pelegrini përmendet edhe në një dokument të datës 9 shkurt 1350 por me emrin dom Pelegrini Shqiptar (*Dompnus Pelegrinus Albanensis*), këtë radhë për një pelegrinazh tjetër të shenjtë për në Romë, së bashku me një klerik tjetër shqiptar dom Palin e manastirit të Shën Kollit të Bunës (*Dompnus Paulus Sancti Nicolay de Oldrino**) për fisnikun Laure Nicolo de Lucchari dhe për Mark Jun Mençion dhe Marin Nikole de Mençion.⁸⁵ Nga ky dokument mësojmë që dom Pelegrini ishte nipi i një kleriku tjetër të rëndësishëm, i dom Nikollës, kapelan i kishës së rëndësishme të Shën Vlashit në Raguzë (*dompnus Pelegrinus nepos domini Nicole capelani sancti Blaxii*)⁸⁶.

Dom Pelegrini nga Baleci duhet të ketë vdekur në vitin 1363, sepse më 30 maj të këtij viti hapet testamenti i tij, për të bërë shpërndarjen e sendeve siç i kishte caktuar ai vetë me shkrim. Edhe pse jetonte për një kohë të gjatë larg vendit të tij, në testament shihet qartë lidhja e ngushtë me Balecin, qytetin ku ishte lindur dhe rritur. Ja çfarë shkruan në testamentin e tij: “Raguzë, më 30 maj 1363. Testamenti i Dom Pelegrinit: Dhe tabori [Taborarja ??- E.M.] ti lihet dom Gjergjit [që jeton] sipër portës së Shën Kollit të Balecit. Mbesës sime Kutës, ti jepen dy sakë (??) dhe tre mantele, kurse bastuni dhe kupa prej bakri ti jepen ipeshkvit të Balecit, dhe Shën Marisë së Balecit ti jepen 12 krahë pëlhurë për mbulesë. Të kujtohen gjithashtu edhe gjërat e tjera në lidhje me «ipeshkvinë e Shën Marisë së Balecit»”⁸⁷. Ky testament ka edhe një

⁸⁴ “(23. Maii 1349). Ex distribution testament ser Stepe de Sorco. Dompnus Pelegrinus de Balleça fuit confessus habuisse a Pascha de Sorgo yperperos X propter ire ad Sanctum Franciscum de Asisio pro anima Stepe patris sui”. AAlb II, nr. 47.

* *Shënim*: Manastiri benediktin i Shën Kollit të Bunës nëpër dokumente quhet Shën Kolli i Drinit (Lu Drino de Oldrino). (shën. aut. - E. M.)

⁸⁵ AAlb II, nr. 66.

⁸⁶ Po aty.

⁸⁷ “1363, 30 maii. Ragusii. Testamentum don Pellegrini: «Et lo taboro sia dato a don Çorçode sopra de Santo Nichola di Baleç et a la mia neça Cutha sia dadi sachi II et mantili III, et lo baçile et lo bocale di rame sia dato alo ueschouo di Baleç et ala Santa Maria di Baleç sia dato braça XII di tela sutile per planeta». Memorantur etiam alia legata «alo uescouado di Santa Maria de Baleç»”. AAlb. II, nr. 188.

rëndësi tjetër, sepse jep të dhëna mbi kishat e ndodhura në Balc, për të cilat do të flitet më poshtë.

Tek klerikët e Balcit bën pjesë edhe prifti Benedikti nga Baleci (*presbiter Benedictus de Ballegio*), i cili përmendet si dëshmitar në një testament të bërë në Raguzë më 18-21 mars 1400 nga Boglina e shoqja e Bogdan Kovaçiqit (*Boglina vxor Bogdanj chouvaçich*).⁸⁸ Po në dokumentet raguzane hasim edhe klerikë të tjerë nga Baleci. Një i tillë ishte edhe dom Pali nga Baleci (*dompnus paulus de ballegio*), i cili përmendet si dëshmitar ligjor në testamentin e dom Palit nga Pulti, të bërë në Raguzë më 3 maj 1400.⁸⁹ Një tjetër klerik ishte edhe dom Benku nga Baleci (*Dompnus Benchus de Ballegio*), i cili në Raguzë merrej me mbledhjen e të dhjetave dhe prodhimeve të hershme (primiceve) për kishën e Shën Marisë.⁹⁰ Ai ishte një figurë e njohur në Raguzë pasi në vitin 1372 bëhet sakrist i Katedrales së Raguzës, më vonë është i dokumentuar si kapelan i zhupës së Brennos duke i njohur me emrin “don Bencho de Breno” dhe pastaj për shkak të moshës së thyer edhe me emrin Dom Benku plaku (*don Bencho Vechio*).⁹¹

Dom Benku i sipërpërmendur ka lënë në Raguzë edhe një testament. Këtë testament e kishin bërë dy klerikë të tjerë, mesa duket sivëllezër të urdhrit dominikan (predikues) Dom Bosiamiloste dhe dom Jon Longo nga Durrësi. Përfituesit e sendeve të tij të lëna me testament ndër të tjerë ishin vëllezërit biologjik e vetë dom Benkut, Dobroslavi*, zoti Pal Markosi tashmë i vdekur dhe Marku, si dhe sivëllezër të tjerë të urdhrit dom Pjetër Vendramin nga Drishti dhe Fra Johani Prior i Predikatorëve (dominikanëve).⁹² Disa vite më vonë, më 19 maj 1404, dom Benku (*don*

⁸⁸ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV..., I (1400-1405)*, nr. 18.

⁸⁹ AAlb II, nr. 640.

⁹⁰ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV..., I (1400-1405)*, nr. 35.

⁹¹ AAlb II, nr. 635, shën. 3.

* Në lidhje me Dobroslavin, këpucar nga Baleci, shih në faqen e dytë të këtij artikulli.

⁹² “1400, 18 mai, Dubrovnik. «Distributio testamenti dompni Benchi de Ballegio facta per dompnium Johannem bosiamiloste don Jon longo de durachio, dobroslaum, ser paulum fraters dicti condam dompni Benchi, Radinum medauiçh, et Stephanum de dulcineum». Parmi les testataires qui conferment d’avoir reçu ce qui figurait sur le testament sont également: «Dompnus Petrus vendermin de driuasto», «dompnus frater Johanes prior predicatorum», «Marcus frater suprascripti dompni Benchi», «Marchozius condam frater dicti dom benchi»”. *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV..., I (1400-1405)*, nr. 37.

Bencho de Balleza) shfaqet edhe në testamentin e klerikut shqiptar dom Mark Kaputapit (*don Marco Caputapis*) këtë radhë si një ndër përfituesit e gjërave të lëna pas.⁹³

Po në Raguzë, dokumentohet në vitin 1401 edhe “Dom Domeniku nga Baleci në viset e Shqipërisë” (*dompnus dominichus de balizio parcium albanie*), por në lidhje me të përveçse disa shlyerje borxhesh, në dokument nuk mësohet asgjë tjetër, as se cilit urdhër i përkiste.⁹⁴ Dom Domenikun nga Baleci (*Dompnus dominichus de ballegio*) e gjejmë edhe nëpër dokumente të tjera, nga një dokument i vitit 1403 mësojmë se ndërmerre pelegrinazhe me porosi të besimtarëve të ndryshëm. I tillë është edhe pelegrinazhi i ndërmarrë me porosi të zonjës Nuçe (*Nuce*), për të cilin ai kishte marrë 50 perperë dhe 4 qirinj të caktuar pikërisht për të në testamentin e zonjës së lartpërmendur. Ky dokument raguzan mban datën 19 mars 1403.⁹⁵ Vendi i shtegtimit nuk jepet.

Aktiviteti i shtegtimeve dhe i pelegrinazheve që kryhej nga klerikë të ndryshëm, sidomos nga kleri i vogël, për shpirtin e besimtarëve është një fenomen i njohur në Mesjetë. Në lidhje me këtë kemi shumë të dhëna mbi klerikë shqiptarë nga Shkodra, Drishti, Pulti, etj., të cilët i kryenin këto shtegtime sidomos në Raguzë dhe në Venedik në këmbim të një shume të caktuar parash, të cilat këtyre klerikëve u nevojiteshin edhe si kosto udhëtimesh. Ky fenomen bëhej më i shpeshtë sidomos në raste kolere apo epidemish të tjera. Për shembull gjatë kësaj kohe nga gjysma e dytë e shek. XIV e deri në fillim të shek. XV, kemi raste të herëpashershme të vdekjeve të shkaktuara nga epidemia, sidomos nga murtaja (ose Vdekja e Zezë) qoftë në Raguzë⁹⁶, qoftë në Shkodër⁹⁷ dhe në krahinat përreth, ku ndodhej edhe Baleci.

Domeniku i lartpërmendur (*presbiter dominichus de Ballegio*), për të cilin marrim vesh se ishte kapelan në Raguzë, na paraqitet edhe në një dokument tjetër të datës 26 shkurt 1404, në lidhje me testamentin e një prifti tjetër shqiptar, të dom Gjergj Fisit nga Pulti (*dompni Georgij fisso de pullat*).⁹⁸ Domeniku nga Baleci, së bashku me një kapelan tjetër

⁹³ *Po aty*, nr. 436.

⁹⁴ *Po aty*, nr. 108.

⁹⁵ *Po aty*, nr. 310.

⁹⁶ Klaus Bergdolt, *Der Schwarze Tod: Die Große Pest und das Ende des Mittelalters*. 3. Auflage. München: C. H. Beck 2011, f. 47.

⁹⁷ AAII, nr. 672; AAIII, nr. 893.

⁹⁸ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV..., I (1400-1405)*, nr. 415.

shqiptar në Raguzë, Dhimitrin nga Deja (*presbiter dymitrius de dagno, chapellanj in Ragusio*) ishin dëshmitarë për këtë testament të bërë më 3 nëntor 1403.⁹⁹ Dom Domeniku na shfaqet edhe në testamentin e Marin Gondules të bërë më 1 dhjetor të vitit 1405, si përfitues i gjërave që kishte lënë.¹⁰⁰

Përsa i përket ndërtesave të kultit, Baleci duhet të ketë pasur të paktën tri kisha¹⁰¹. Rrënojat e njëjës prej tyre i evidenton edhe Theodor Ippen në vitin 1907. Ai shkruante që rrënojat e një kishe ndodheshin në majë të kodrës së Balecit dhe ishin të rrethuara me shkurre të dendura. Nga përmasat e këtyre rrënojave kishin mbetur 20 hapa gjatësi dhe dhjetë hapa gjerësi së bashku me një pjesë të absidës.¹⁰² Muri i kësaj kishe ishte shumë i thjeshtë dhe pa ornamente.¹⁰³ Kjo kishë në majë të kodrës duhet të ketë qenë *Katedralja e Shën Marisë së Balecit*, ku zhvillonte aktivitetin ipeshkvi i Balecit (*uescovado di Santa Maria de Baleç*)¹⁰⁴. Kjo kishë katedrale duket se ka pasur edhe kuvendin e saj katedral, çka tregon se ishte e organizuar në mënyrë të rregullt.¹⁰⁵

Në vitin 1363, kësaj kishe dom Pelegrini, për të cilin folëm edhe më lart, i lë me testament disa objekte ndër të tjera edhe një kupë bakri.¹⁰⁶ Katedralja e Balecit kishte edhe kapitullin e saj (*capitulo et clero ecclesie Balezencis*)¹⁰⁷, një kapitull që duhet të ketë qenë i ngjashëm me atë të Drishtit, pasi, sikurse në Drisht edhe në Balc kleri i përkiste kryesisht Urdhrit Françeskan dhe këtë e vëmë re kryesisht nga ipeshkvijtë e Balecit (jo titullarët) të cilët i përkisnin këtij urdhri.¹⁰⁸ Ky kapitull mbase ka pasur edhe statutet e tij, por diçka e tillë nuk përmendet asgjëkund nëpër dokumentet e pakta që janë të disponueshme deri tani. Kapitulli i Katedrales së Balecit përmendet në dy dokumente. Njëri i përket datës 5 mars 1347 dhe është një letër e Papës Klementi VI dërguar nga Avinjoni, Gjonit, kryeipeshkvit të Tivarit, *Kapitullit dhe klerit të Kishës së Balecit*

⁹⁹ AAlb II, nr. 743.

¹⁰⁰ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV..., I (1400-1405)*, nr. 571.

¹⁰¹ K. Jireček, "Skutari und sein Gebiet ...", f. 100.

¹⁰² Th. Ippen, "Denkmäler verschiedener Altersstufen ...", f. 9.

¹⁰³ Po aty.

¹⁰⁴ AAlb II, nr. 188.

¹⁰⁵ F. Kordinjano, *Shqipëria. Përmes veprës dhe shkrimeve ..., II*, f. 33.

¹⁰⁶ AAlb II, nr. 188.

¹⁰⁷ AAlb II, nr. 30.

¹⁰⁸ D. Farlati, *Illyricum Sacrum VII...*, f. 207: AAlb II, nr. 85.

(*capitula et clero ecclesie Balezencis*) me rastin e vdekjes së Gervikut, ipeshkvit të kësaj dioqeze¹⁰⁹.

Dokumenti tjetër është shkruar disa vite më vonë, më 1 qershor 1351, po nga Papa Klementi VI me rastin e shugurimit të françeskanit



Fig. 5: Këndi jugperëndimor i një rrënoje kishe në Balezencë.
Foto: Th. Ippen, "Denkmäler...", f. 8.

Andreas Citer si ipeshkëv i ri i Balezencit. Papa u drejtohet klerikëve të kapitullit me fjalët "bijve të dashur të Kapitullit të Kishës së Balezencit" (*dilectis filiis capitulo ecclesie Balezencis*).¹¹⁰ Kisha tjetër mund të jetë pikërisht ajo e ndodhur në fshatin Shën Aleksandër, në kodrën e Balezencit, buzë lumit Rrjoll.¹¹¹ Kurse kisha e tretë përmendet

në vitin 1363 si Kisha e Shën Kollit të Balezencit (*Santo Nichola de Balezencis*), e cila përmendet edhe në testamentin e dom Pelegrinit¹¹², për të cilin folëm më lart.

Në lidhje me klerin duhet të shtojmë që nuk përjashtohet edhe mundësia e pranisë së Urdhrit Dominikan, me herët edhe të atij Benediktin pasi në afërsi ishte Manastiri i Shën Gjonit të Shtojit për të cilin do të flitet shkurt më poshtë. Gjithashtu, siç konstatohet edhe nga dokumentet, mbajta e titullit *Dom* (*dompnus, dominus*) e shumë klerikëve dhe nga Balezencit nuk përjashton mundësinë e pranisë së dioqezanëve në këtë qytet dhe në fshatrat përreth tij.

Përkohësisht kësaj dioqeze i përkiste edhe manastiri benediktin i Shën Gjonit të Shtojit (*monasterium s. Johannins Ordinis s. Benedicti Drivastensis diocesis*¹¹³ ose *abbatia s. Johannins de Strilalio districtu*

¹⁰⁹ AAII, nr. 30.

¹¹⁰ AAII, nr. 85.

¹¹¹ "Sancto Alexandro sotto Balezencis", hodie "Kisha e Balezencit" super fluvio Rioli ex orientale plaga lacus Scutarensis", AAII, nr. 653, shën. 1.

¹¹² AAII, nr. 188.

¹¹³ AAII, nr. 93, ref. 3.

*Drivasti*¹¹⁴), rrënojat e të cilit ndodhen sot në fushën e Shtojit, pesë milje larg nga rrënojat e Balecit. Nga popullsia përreth njihen edhe me emrin “*Kisha e Shën Gjinit*”. Siç e mësojmë edhe nga vetë emri i manastirit, ai i përkiste më parë dioqezës së Drishtit por komenda e tij i kaloi dioqezës së Balecit përkohësisht.

Ky kalim u bë për shkak se të ardhurat e Kishës së Balecit në atë kohë qenë pakësuar aq shumë “nga skizmatikët e mbretërisë së Rashës”, ipeshkvi i Balecit (që në atë kohë ishte françeskani Andreas) që nuk kishte me se të jetonte, dhe për këtë arsye, rreth datës 26. 10. 1356 iu dha nga Papa Innocenti VI si komendë, manastiri benediktin i Shën Gjinit në Shtoj (Strilaleo) që ndodhej në dioqezën e Drishtit.¹¹⁵ Manastiri duhet të ketë qenë i pasur me prona të patundshme, të cilat shtriheshin edhe jashtë rrethit të Drishtit.¹¹⁶

Ky manastir pati probleme të shumta nga ortodoksët sllavë, ashtu siç pati edhe ipeshkvia e Balecit në afërsi të tij, sepse në vitin 1356 thuhet se abacia e Shën Gjinit në Drisht ishte shkatërruar krejtësisht nga ortodoksët (*ab ipsis schismaticis quasi totaliter dissipatum*).¹¹⁷ Megjithatë, me gjithë kërcënimin skizmatik, ai u ringrit shumë shpejt, pasi 20 vjet më vonë është e dokumentuar që Papa Gregori XI urdhëron më 29 shkurt 1376 Pjetrin, kryepeshkëv të Raguzës, që të zgjedhë ndonjë murg benediktin të atyre vendeve dhe ta caktojë si abat, pasi abati i fundit Mihael kishte vdekur “*monasterio S. Johannis Baptiste dicti ordinis Drivastensis diocesis, per obitum Michaelis abbatis vacanti*”. Gjatë kësaj kohe duhet të ketë ndodhur edhe kalimi i manastirit nga dioqeza e Balecit sërish në dioqezën e Drishtit.

Në zonë njihet edhe Kulti i Shën e Premtes apo i Shën Prenës (Shën Venerandës, martire e krishterë romake, tek ortodoksët Shën Parashqevi, tek sllavët Sveti Petka), i cili ishte i përhapur kryesisht në fiset malësore

¹¹⁴ Po aty.

¹¹⁵ AAlb II, nr. 119; Fulvio Cordignano, “Antichi monasteri benedettini in Albania. Nella Tradizione e nelle leggende popolari”, në *La Civiltà Cattolica*, Anno 80 - 1929, vol, quad. 107 (27 novembre 1929), f. 18.

¹¹⁶ Oliver J. Schmitt, “Paul Angelus, Erzbischof von Durrazzo und seine Bedeutung für den Türkenkampf Skanderbegs”, në: *ΘΗΣΑΥΡΙΣΜΑΤΑ* 30, 2000, f. 131.

¹¹⁷ AAlb. II, nr. 119; M. Šufflay, “Kirchenzustände ...”, në *Forschungen I*, f. 278; Gjon Bazhdari, “Përmii Historen e Shqypniis. Nji Abacii tieter e Benedetinve”, në *Elçija i Zemers Jezú Krishtit*, nr.6. II/1912, f. 71.

që jetonin përreth luginës së Rrjollit,¹¹⁸ dhe që pati vazhdimësi të paktën deri në fillim të shek. XX.

* * *

Këto pra ishin disa të dhëna mbi qytetin mesjetar të Balecit, i cili mbetet akoma enigmë për historinë, pavarësisht se ka pasur një jetë afro njëmijëvjeçare duke filluar nga Antikiteti i Vonë apo Mesjeta e Hershme e duke përfunduar si qytet në periudhat e para të Mesjetës së Vonë.

S u m m a r y

BALEC IN THE MIDDLE AGES

The goal of the article is to give data on the history of Balec, a town lying a few kilometers to the Northwest of Scutari and existing from the Early Middle Ages to the beginning of the Late Middle Ages and its heyday should have been in the 14th century. We come across some data on this town by Ippen, Farlat, Jireček, Šufflay, Schmitt etc. The first medieval source where the name of this town shows up is the Dioclea Presbyter's writing about 1200. By this article based on the abovementioned authors or documentary sources we attempt to surpass what has been written so far on this town and to bring into light as much as possible the quite dark and enigmatic history of this medieval domicile about which we find almost no data at all in the whole Albanian historiography so far. The article is divided into two parts which deal with two different aspects of it: the secular world (data on the town, population and its economy), that is the first part and the religious world, that is the second part of the article, where the history of the diocese, of the Bishopric and of the clergy of medieval Balec is treated.

¹¹⁸ Th. Ippen, *Die Gebirge des Nordwestlichen ...*, f. 19.